



PROCESVERBAL V/2023

I mbajtur me rastin e mbledhjes së V (pestë) për vitin 2023 të Komitetit për
Politikë dhe Financa të KK Suharekë

Vendi: KK Suharekë
Zyra: Salla e Bordit të Drejtorëve
Data: 23.05.2023
Ora : 13:00

Prezentë:

Z. Bexhet Kuçi - Kryesues
z. Urim Suka
znj. Bulëza Kuçi
znj. Sanie Kuçi Rexhepaj
znj. Fidaije Kukaj
z. Dardan Berisha
z. Liridon Fandaj

Të pranishëm tjerë:

Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim
Përfaqësues i OSBE-së
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

Rend dite

1. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;**
3. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;**
4. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;**
5. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-21225;**
6. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për faljen e borxheve të pa paguara;**
7. **Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 të barten për shfrytëzim në vitin 2023;**
8. **Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;**

Urim Suka - ka disa mbledhje që ne si grup presim që të sillni raportin e Kryetarit sepse edhe në plan të punës parashihet raporti vjetor i Kryetarit në muajin mars por nuk na ka ardhë. Unë kisha kërku të futet si pikë shtesë raporti vjetor i Kryetarit.

Sanie Kuçi Rexhepaj - mbledhjen e kaluar e kam ngrit një shqetësim për të disatën herë që nuk po raportohet rreth zbatimit të planit zhvillimor të Komunës. Si shqetësim që e ngrita mbledhjen e fundit thashë që nëse nuk vjen as këtë mbledhje,unë nuk do ta miratojë asnjë pikë të rendit të ditës për shkak që më duket papërgjegjësi e Komunës mos sjellja e këtij raporti e cila është edhe obligim ligjor. Në diskutimin që kemi pas është premtu që është duke u punu në atë aspekt dhe ka me u sjell shumë shpejtë. Po shpresoj që mbledhjen e ardhshme të silllet pika që kam kërkuar.

Kryesuesi - unë kam bisedua me Kryetarin dhe Drejtorin e Urbanizmit për këtë çështje për me insistu te zyra e urbanizmit dhe ata janë zotu që e kanë formu komisionin për menaxhimin e PZHK-së dhe shumë shpejt do ta sjellin mirëpo ata ankohen që nuk ka staf.

Sanie Kuçi Rexhepaj - monitorimi është diçka sistematike dhe unë i kuptoj sfidat e stafit sepse kam qenë pjesë e ekzekutivit dhe për atë arsye kur e ngrita në janar si çështje thashë që ti japim kohë me hartu sepse ajo është punë sistematike që duhet të bëhet prej fillimit të janarit 2023.Ne i presim deri sa ta përfundojnë por që të mos i kalojnë komplet pritjet tona.

Kryesuesi - sa i përket shefit të grupit parlamentar të LDK-së për një pikë shtesë lidhur me raportin e Kryetarit,unë kisha kërku që me mirëkuptim ta lëmë muajin tjetër.

Reshat Reshitaj - unë e di që është publikuar raporti dhe plani i punës i Kryetarit.

Urim Suka - unë po kërkoj me raportu në Kuvend.E kemi miratu raportin ndërsa ai po thotë që është gati.Është dasht me ardhë në mars dhe ne mos me ngrit këtë temë fare.

Kryesuesi - nëse po e kërkon një raport gojor,është në rregull por nëse e doni raportin në formë të shkruar me përgatit dhe t’ua dërgojmë,nuk e di a do të mund ta përgatitemi për ta përcjell materialin.

Urim Suka - nëse unë marrë garanci që në seancën tjetër ky raport vjen atëherë e lëmë për seancën tjetër.

Avni Bytyqi - mos kërko zotim prej Kryesuesit sepse Kryetari do të raportojë. Nëse e ka raportin gati Kryetari,e sjellim,nëse nuk e ka gati,mbledhjen e radhës e përgatit dhe e sjellim.

Kryesuesi - unë do ta ngris si shqetësim te Kryetari sepse me përcjell si material për sot është problem ndërsa për seancën tjetër me ardhë si raport në KPF.

Urim Suka - në rregull, e pranoj mirëkuptimin.

Dardan Berisha - të gjitha pikat që janë të parapara sipas ligjit që të raportohen në Kuvend, besoj që të gjitha kanë me u implementu. Nëse i takon Kryetarit me ligj me raportu, besoj që raporton sepse edhe ai nuk është i interesuar me shkel ligjin.

Urim Suka - po insisto sepse nuk ka kuptim me na ardhë raporti i vitit 2022 në dhjetor të vitit 2023. sepse është larg. Duhet të vijë më së largu në mars për arsye se ne duhet me ditë çka po raporton dhe ti kemi të freskëta ato çka kanë ndodhë.

Avni Bytyqi - Kryetari jep llogari para qytetarëve dhe i raporton qytetarëve dy herë në vit për punën dhe aktivitetet e tij gjatë vitit të kaluar ndërsa për çështjet ekonomike financiare ka për obligim çdo tre muaj me ju raporton dhe është duke raportu. Nëse është në vullnetin e Kryetarit, mund të del të raportojë para Kuvendit dhe nëse s'është nuk e ka obligim ligjor.

Urim Suka - e ka obligim ligjor sepse e ke fut në plan të punës dhe është miratu.

Kryesuesi - pika që ngriti Urimi tërhiqet. E hedh në votim rendin e ditës.

Unanimisht Miratohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Urim Suka - unë dua ta ngris një çështje te procesverbali që për mua është bazike. Te çështja e fundit e petitionit ka ndodh diçka që nuk është dasht me ndodh dhe ajo askund nuk figuron dhe për mua është e çuditshme sepse ka kalu pika dhe pastaj është kërkuar që të bëhet edhe një votim.

Sanie Kuçi Rexhepaj - te peticioni kur e kam marrë fjalën, kam thënë: për deri sa i keni pas 11 nënshkrime keni mund ta sillni si pikë të rregullt të rendit të ditës ndërsa në procesverbal figuron 20 nënshkrime.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 1 me dy vërejtjet që u dhanë.

Unanimisht Miratohet

Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shpalljen “Qytetar Nderi” i Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Bulëza Kuçi - a është kërkesë e Kryetarit apo kërkesë e këshillit iniciativë?

Kryesuesi - si kërkesë e kam bisedu me Kryetarin dhe më tha me vendos si pikë dhe nuk e kam lexu atë pjesë të këshillit iniciativ.

Bulëza Kuçi - do të thotë është kërkesë e këshillit drejtuar Kryetarit.

Kryesuesi - ndoshta iu kanë drejtuar Kryetarit por unë dhe Kryetari i caktojmë pikat e rendit të ditës.

Avni Bytyqi - mbledhjen e kaluar në KPF ka kërku me fut si pikë të jashtëzakonshme por nuk e kemi preferuar një gjë të tillë për arsye se ka qenë kërkesë e këshillit iniciativ në bashkëpunim me tre ish Kryetarët e Komunës. Kryetari i Komunës e ka përkrah iniciativën dhe ka kërku nga ta që ta adresojnë kërkesën te zyra e Kryetarit dhe Kryetari në bashkëpunim me Kryesuesin ta caktojë si pikë dhe të vje mbledhjen e radhës.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 2.

Unanimisht Miratohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e propozimeve të komisionit për dhënien e shpërblimeve “Emblema e artë”, “Skënderbeu” dhe mirënjohjen “13 Qershori”;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe i njofton me propozimet që kanë miratuar si komision. Hap debatin.

Bulëza Kuçi - vërejtjet po thua që i kanë plotësu sepse ne i kemi votu me disa vërejtje ku kemi kërkuar ti sjellin dokumentet në mungesë. Një ngatërresë të një emër ta sqarojmë sepse mos po ndodh në Asamble ndonjë keqkuptim.

Kryesuesi - kërkesa ka qenë e OVL Suhareka ku e ka ngatërru mbiemrin. E kanë bërë Selmanaj dhe faktikisht ka qenë Aliaj dhe ne e kemi rregullu.

Sanie Kuçi Rexhepaj - është dhe një gabim teknik ku është shënuar Komunavë dhe Maqedini.

Urim Suka - kërkoj pak informacion. A kanë marrë dëshmorë të tjerë dhe a keni ndonjë regjistër se kush prej Dëshmorëve po merr dhe sa dëshmorë nuk kanë marrë? Apsolutisht nuk kontestohet por vetëm ta dimë që ti kemi parasysh edhe herave tjera.

Avni Bytyqi - si zyrtar ligjor thotë që në 2003 është themeluar çmimi "Emblema e artë" si çmimi më i lartë, është çmimi "Skënderbeu" dhe mirënjohja "13 Qershori". Deri në vitin 2018 janë dhënë 13 mirënjohje për 13 qershor me simbolikën e datës së çlirimit të K. Suharekës dhe në 2018 u zvogëluar në numrin 5. Çmimi "Skënderbeu" në momentin kur është themeluar, në total i ka dhënë të gjithë Dëshmorëve. Kohë pas kohe duke u zbulu rastet e dëshmorëve dhe martirëve që janë vra nga dora e serbit, janë dhënë shpërblimet për çmimin "Skënderbeu", mirëpo tri vitet e fundit nuk ka pas propozime dhe këtë vit kanë ardhë dy propozime dhe njëri prej tyre i ka plotësu kushtet dhe iu ka propozu Kuvendit që t'i jepet çmimi "Skënderbeu".

Urim Suka - do të thotë nuk kanë marrë krejt.

Avni Bytyqi - zyrtari ligjor jep sqarime.

Urim Suka - ata që i kemi në lista të Komunës a kanë marrë të gjithë?

Avni Bytyqi - po.

Urim Suka - martirët a kanë marrë të gjithë?

Avni Bytyqi - po, kush i ka propozu.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 3.

Unanimisht Miratohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e planit planit komunal për ri-integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Xheladin Sadikaj - Personat e zhvendosur llogariten të gjithë ata persona të komuniteteve që janë zhvendosur gjatë periudhës së luftës. Pra kemi aspektin e ri integrimit, riatdhesimit dhe të huajve në Komunën e Suharekës. Kemi planin qeveritar i cili është adaptu në akt Komunal dhe është kërku që të procedohet për Asamble.

Urim Suka - për cilat kategori ka të bëjë kjo?

Xheladin Sadikaj - është plan komunal për ri integrim të qëndrueshëm për persona të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Suharekës.

Avni Bytyqi - personat që kthehen nga bota e jashtme dhe që në pamundësi të gjetjes së strehimit dhe ndihmës financiare duke vazhduar jetën në Kosovë, Komuna e merr obligim ti financojë. Ne e kemi komisionin i cili i shqyrton kërkesat e tyre dhe ti rekomandoj Kryetarit të Komunës që ti ndihmojë me pako ushqimore, strehim deri sa të ata të adaptohen, min. për 6 muajt e parë me mundësi vazhdimi edhe për 6 mujin e dytë.

Xheladin Sadikaj - ky program për ri integrim financohet nga ministria e Punëve të Brendshme.

Dardan Berisha - a bashkëpunoni me ndonjë organizatë tjetër?

Xheladin Sadikaj - po.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 4.

Unanimisht Miratohet

Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-21225;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - nëse nuk gaboj, në KPF dhe në Asamble janë ngrit këto shqetësime që ministria i ka kthye dhe ju nuk i keni dëgjuar shqetësimet tona. Është shqetësuese sepse gati çdo mbledhje po na vje me shfuqizuar nga një vendim. Duhet me qenë më serioz në temat që po i trajtojmë. Ne duhet ta shfuqizojmë këtë vendim sepse nuk mund t'ja lëmë barrë Komunës një vendim që s'është në përputhje me ligj.

Liridon Fandaj - është keq nëse si ekzekutiv e sillni një vendim në Asamble dhe nuk e shikoni. Ndoshta është edhe mungesa e atij raporti që nuk e përcjell askush dhe nuk e dim se çka bohet dhe na vin vendime me i shfuqizua dhe mbledhjen tjetër me i shfuqizua. Është mirë ti shikoni paraprakisht.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 5.

Unanimisht Miratohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për faljen e borxheve të pa paguara;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - për mua është e çuditshme dhe e pakuptueshme. Pse nuk është lista e borgjeve kur ju si duket e keni dërgu në ministri ashtu si edhe po shkruan. Ne duhet ta dimë se për çfarë borxhe po flasim.

Kryesuesi - dje e kanë përgatit dhe nuk kemi mundur ta përcjellim si material. Në Asamble do ta keni.

Urim Suka - me këto vërejtje ne do ta përcjellim për Asamble dhe e diskutojmë atje.

Liridon Fandaj - dua të ndërlidhem te ajo që thekë e kanë shfrytëzuar të gjitha partitë politike. Unë mendoj që secila parti politike e ka një buxhet të vetin dhe s'duhet me amnistu as partitë politike por as klubet sportive sepse këto financohen edhe marrin subvencione edhe prej Drejtorisë së Kulturës dhe prej ministrisë. Është kosto që duhet me mirëmbajta dikush këtë palestër dhe mos ta bëjmë si praktikë që t'ja falim ne dhe ata të vazhdojnë të njëjtin avaz. Nëse Drejtoria e kulturës i subvencionon ato klube, ata në planin e vet financiar duhet me parapa edhe pagesën e palestrës.

Dardan Berisha - realisht desha të kërkoj ndonjë raport që ta dimë kush sepse kur po ndahen subvencionet, po ndahen në mënyrë proporcionale dhe ndoshta është mirë ta bëjmë dallimin e klubeve se cilët janë më të pa përgjegjshëm sa i përket shfrytëzimit të sallës 13 Qershori.

Urim Suka - këto çështje që i ngrita, i ngrita për me rregullu një çështje për më gjatë. P.sh. Është një klub që me siguri i ka pagu vazhdimisht dhe janë disa klube tjera që si kanë pagu kurrë dhe ne tash po e marrim në vendim që me ia fal atyre që s'kanë pagu. Nëse ka një situatë të tillë, është mirë që ai që ka pagu, me subvencionu me diçka ose me mbështet për vitin e ardhshëm që mos të paguaj fare ose për 5 vite

Nëse kjo rregullore po i krijon vështirësi klubeve, pse ne me i akumulua këto borxhe 10 vite dhe me marrë vendim. T'ja bëjmë një tarifë më të vogël sepse mënyra se si po veprojmë është gabim.

Kryesuesi - është duke u mbjatur një evidencë me përpikëri në bazë të asaj që e kam pa dje. Çdo kush që e shfrytëzon është e regjistruar. Ne e përcjellim në Asamble, e diskutojmë dhe marrim hapa tjera se çka mund të bëjmë. E hedh në votim pikën 6.

Unanimisht Miratohet

Pika 7. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake për vitin 2022 të barten për shfrytëzim në vitin 2023;

Kryesuesi - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

Urim Suka - ju e patë që ne e kemi votu këtë por atëherë kanë qenë rreth 1 milion euro që ju kanë tepru dhe tash po del që nuk keni arritë me i shfrytëzua ato 1 milion euro. Tash me këtë vendimin e ministrisë po del që edhe të viti 2021 ju nuk i keni shfrytëzu dhe kjo i bie që afër 450 mijë po humbin.

Kryesuesi - ti je dëshmitar që në vitin 2021 Komuna ka pas 30 % më tepër të hyra vetanake.

Urim Suka - ato që kanë qenë më tepër, ti po i bartë dhe unë po flas për ato që po t'humbin.

Kryesuesi - nuk humbin, prap kthehen edhe ato.

Urim Suka - ne nuk e mbështesim një vendim të tillë për shkak të mënyrës se si i keni shpenzu paratë dhe mënyrës se si keni votu edhe më herët për ne.

Liridon Fandaj - te 182,779.44€ nuk mund të japim vërejtje këtu sepse këto janë të tre mujorit të fundit,që këto edhe me desht me i shpenzu nuk mundesh sepse janë të skualifikune. Te pjesa 304,355.00€ është një keq planifikim ose nuk ka pas projekte për mu shpenzu. Unë nuk pajtohem me atë që qeveria duhet me i ndal të hyrat vetanake por në njërin anë pajtohem që ti i ke paratë në dispozicion dhe nuk po din ti shpenzosh ato.Atëherë s'bën të bartën vit në vit sepse kjo ka qenë trend që me i bart në vitin e fundit të fushatës dhe ato para me i shfrytëzu për projekte kapitale.

Kryesuesi - nuk dua ta mbroj ekzekutivin në këtë rast por te shuma e dytë që përmende,të gjitha këto janë mbetje të projekteve kapitale. Psh.te rruga fushore është e paraparë rruga 140 mijë euro por po hyn me 80 mijë euro dhe po mbesin mbetje.

Liridon Fandaj - është dasht me sjell një vendim që këto pare nëse i ka planifiku brenda vitit,mi bartë në ato projekte por jo në fund se në cilat projekte po na konvenon.

Labinot Halitjaha - pjesën prej 380.000 € të vitit 2021 qeveria e ka parapa si keqklasifikim dhe ka kalu nga viti 2021 në vitin 2022. Qeveria e ka nxjerr një rregullore që të hyrat vetanake me i ndal nëse keni mujt me i shpenzu. Drejtori tutje jep sqarime.

Urim Suka - gjithë buxhetin e vitit 2022 e ke keqklasifikim.

Labinot Halitjaha - këto rregullore janë për herë të parë dhe ne do ti përshtatemi.

Urim Suka - ka shkurtime buxhetore te ndërtimi dhe rregullimi i Kolektorit në rrugën “Skënderbeu” dhe te ndërtimi i rrugës Sopijë-Vraniq,Reqan-Bukosh.A po të rrezikohen këto projekte drejtor?Mos po ndodh që ju e filloni punën atje dhe i leni në kaos njerëzit kur s'ka mjete buxhetore?

Enver Shabani - nuk ke nevojë të shqetësoheni sepse projekti i Kolektorit do të kryhet me mjetet që janë dhe mjete të cilat i kemi huazu vitin e kaluar nga projektet dhe do t'ia kthejmë kodit Skënderbeu.Sa i përket rrugës Reqan-Bukosh nuk do të rregullohet kurse sa i përket rrugës Sopijë-Vraniq do të rregullohet me asfalt,e ka fitu tenderin firma.Në rrugën Samadraxhë kanë fillu punimet.Drejtori tutje jep sqarime

Urim Suka - termin huazim nuk e kuptova dhe sa e di huazim nuk ke drjetë me dhënë.

Enver Shabani - ne nuk jemi në gjyqësi kush ka drejtë e kush jo.Borgj nuk i kemi mbet askujt dhe punët po kryhen.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 7.

4 për,3 kundër
Miratohet pika 7

Pika 8. Shqyrtimi i projekt-Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në territorin e Komunës së Suharekës;

Kryesuesi - është e njëjta projekt-rregullore që e kemi diskutu mbledhjen e kaluar e cila nuk është mirartu mirëpo Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe grupi punues i kësaj rregullore po kërkojnë që e njëjta rregullore të dërgohet në Asamble. Kryesuesi tutje jep sqarime dhe kërkon që të përcillet për Asamble.

Urim Suka - te kjo tash çka po folët, për mua është më shqetësuese se krejt çka folëm deri tash edhe pse edhe përgjigja e drejtorit ishte shqetësuese.Kjo projekt-rregullore ka ardhë një herë në Asamble dhe është votu kundër. Me sjell të njëjtën rregullore prap në Asamble është presion dhe shantazh i Asamblesë.Këtë rregullore keni mujt me sjell prap nëse e bëni ndonjë ndryshim por jo të njëjtën me sjell.Kjo është kundër rregullave të demokracisë dhe kjo është shantazh i drejtpërdrejtë.Nëse doni,bëjeni por është gabim.

Kryesuesi - nuk mundesh me thënë që është shantazh.Ky është mendimi yt.

Liridon Fandaj - ndoshta është gabim teknik por këtu thotë që Kuvendi i K. Suharekë në mbledhjen e mbajtur 28.02.2023 miratoi këtë rregullore. Kjo rregullore e parash vetëm rritjen e një takse për qytetarë. Nëse ju e ndryshoni këtë rregullore dhe vje një vendim i shkruar që këtyre punëtorëve i rritet paga dhe e merr Eko Regjioni, atëherë votat tona janë pro.Por me këtë rregullore që njëherë nuk ka kalu dhe nuk parash rritje të pagave të punëtorëve, ne nuk e përkrahim.

Sanie kuçi Rexhepaj - Urimi po thotë që nuk mundem ta ndryshoj mendimin. Personalisht,kur ka ardhë herën e parë kam qenë në dyshime dhe kam mbajtur takim me zyrtarët e EkoRegjionit dhe e kam ndryshu mendimin. Kështu që është gjë normale me ndryshu mendimin.

Urim Suka - Ne po flasim për vendimin. Kuvendi ka marrë vendim që kjo pikë mos me kalu në këtë formë dhe me sjell prapë është shantazh.

Kryesuesi - e vërtetë që nuk shkruan në rregullore për rritje të pagave por kur ka të hyra më shumë edhe ata stimulohen.

Liridon Fandaj - mos thirri në atë se do t'ja rrisni pagat punëtorëve sepse kjo rregullore nuk e parasheh.

Kryesuesi - këta që i deponojnë mbeturinat atje, e paguajnë më shtrenjtë tonin.

Liridon Fandaj - 2 euro është në ton më shtrenjtë. Nuk është ajo përqindja e rritjes dhe nëse lidhemi te shfrytëzimet e derivateve, derivatet kanë rënë. Nëse lidhemi te punëtorët, unë personalisht kisha thënë edhe 7 euro .

Dardan Berisha - ekziston një komision prej Asamblesë që është zgjedh për Eko Regjoin dhe nuk e di a është funksional por legjislaturën e kaluar kam qenë unë në komision për Eko Regjion. Gjithë ashtu është edhe anëtari i bordit i cili i ngrit shqetësimet që kemi. Shqetësim nuk është vetëm te paga por është edhe çështja e makinerive sepse vetëm dy javë që nuk janë marrë mbeturinat, e dini shqetësimin që kanë pas qytetarët.

Kryesuesi - e hedh në votim pikën 8.

**4 për, 3 kundër
Miratohet pika 8**

Takimi përfundoi: 14:15

Procesmbajtësja:
Dafina Haziraj